

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTIME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	617-25-6934-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TRIANGLE SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

23000

(Kodi postar)

049 473 653

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ukë Baftjaraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

triangle.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.08.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi për kontrate i datës **30.07.2025**
2. Dosja e tenderit e datës **11.08.2025**
3. B54 Formulari standard për korigjim të gabimeve **01.08.2025**
4. B54 Formulari standard për korigjim të gabimeve **11.08.2025**

**Me datë 07.08.2025 kemi parashtruar Kërkesen për Rishqyrtim në AK, ku është aprovuar pjesërisht kërkesa jonë për rishqyrtim por nuk i ka hequr kriteret diskriminuese.
Me datën 19.08.2025 kemi parashtruar Kërkesen për Rishqyrtim në AK, ku është refuzuar.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

Procesverbali i hapjes është pranuar me kohë përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Zyra e prokurimit e Autoritetit Kontraktues KK Shtime me datën: **30.07.2025** ka publikuar njoftimin për kontratë për prokurimin me nr. të prokurimit dhe titull të lartcekur. Ne kemi shprehur interesim në lidhje me procedurën në fjalë me ç'rast kemi shkarkuar dosjen e tenderit. Pasi kemi analizuar dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë kemi vërejtur që Autoriteti Kontraktues kishte paraqitur kritere diskriminuese të cilat bien ndesh me legjislacionin e prokurimit. Të pa kënaqur me njoftimin e AK-s dhe me kriteret diskriminuese të cilat nuk ishin relevante me natyrën e projektit ne **me datën 07.08.2025 dhe 19.08.2025 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit** me të cilën kemi kërkuar që:

AK të shqyrtojë kërkesën tonën për rishqyrtim, të pezullon zbatimin e këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe të nxjerrin:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik :

TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë** me nr. të prokurimit: **617-25-6934-5-2-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Spitali Regjional-Prizren.

NDRYSHOHEN DHE PËRMIRËSOHEN Kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njejtat të paraqiten në përshtatje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit.

Përndryshe do të detyrohem të paraqitja ankesë në Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Edhe pas dokumentimit të shkeljeve të cilat i ka bërë AK me fakte dhe prova, AK në mënyrë të kundërligjshme pa i marr për bazë provat e paraqitura me pretendimet

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përgatitur dosjen e tenderit në pajtim me qëllimin dhe kërkesat ligjore të prokurimit publik, sepse tek kriteret e kapacitet profesional janë vendosur kërkesa jo relevante dhe me efekt avantazhi për të favorizuar OE që janë të identifikueshëm, dhe nga ana tjetër për të eliminuar konkurrencën e lirë në mesin e OE. Në këtë mënyrë janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së dhe legjislacionit sekondar si më poshtë:

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së lidhur me parimet bazike nga neni 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik;

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 6 pika (i), pika (iii) i LPP-së lidhur me parimet bazike 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik

Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te Rregullave te prokurimit publik.

Neni 17 paragrafi 12, dhe paragrafi 17 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25.4 i Rregullave për Prokurim Publik lidhur me nenin 8 pika 3, pika 4 dhe pika 5 e Udhëzuesit Nr. 001/ 2023 për Prokurim Publik;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me njoftimin e dates **11.08.2025** mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Shtimes ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë** me nr. te prokurimit: **617-25-6934-5-2-1 dhe pas aprovimit të pjesërishtëm të kërkesës tonë për rishqyrtim në AK, duke pasur parasysh që ankesa jonë është aprovuar si pjesërisht e bazuar** ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

Për shkak se AK- **KOMUNA SHTIME**:

- Në mënyrë të kundërligjshme ka caktuar kriterët e përzgjedhjes duke favorizuar operator ekonomik sepse ka përcaktuar kriteret të cilat nuk janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë si dhe na ka diskriminuar neve dhe operatorët ekonomik tjerë të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Sqarojmë ne mënyrë te detajuar :

Në vazhdim do të sqarojmë në mënyrë të detajuar diskriminimin dhe shkeljet që janë bërë me rastin e përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes për procedurën në fjalë e të cilat nuk janë hequr edhe përkundër se ne me kërkesën për rishqyrtim e kemi dëshmu se AK ka vendosur kriteret diskriminuese:

Pas analizimit në tëresi të përmbajtjes së dosjes së tenderit, kemi gjetur se, dosja e tenderit bie ndesh me parimet dhe kërkesat qenësore të prokurimit (barazia në trajtim/jo-diskriminimi) për arsye se tek kriteret e gjendjes ekonomike dhe financiare si dhe te kapacitetit teknik janë vendosur kërkesa jorelevante, kërkesa haptazi të përshtatura për OE të identifikueshëm, respektivisht që krijojnë disfavore dhe kufizojnë konkurrencën në dëm të operatorëve tjerë ekonomik në kundërshtim me nenin 7 lidhur me nenin 51 të LPP-së, nenin 17 të Rregullores. 001/ 2022 dhe nenin 8 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Konkretisht bëhet fjalë për një rënë pikë nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që si të tillë është jo relevante me objektin e kontratës dhe krijojnë favore në dobi të një palë, respektivisht disfavore në dëm të OE tjerë e të cilat janë të vendosura në nenin **9.1 & 9.2** të FTD-së të dosjes të tenderit, të radhitura si më poshtë:
Përmes kësaj shkrese zyrtare, paraqesim **kërkesë për rishqyrtim** lidhur me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit të sipërpërmendur, përkatësisht për **Kërkesat 5, 6 dhe 7.1**, të cilat konsiderojmë se janë të **tejkalueshme, joproporcionale dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik**, sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe udhëzimeve administrative përkatëse.

9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional:: Kërkesa 5.OE duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim Emri , mbiemri,profesioni, minimumi 5 Punëtor,dhe te kete sepaku 2 puntore te certifikuar per instalimin e te gjitha llojeve te dyshemes dhe fushave sportive me standarde te FIBA-s

Kërkesa për

- **minimum 5 punëtorë**, dhe veçanërisht
- **2 punëtorë të certifikuar për instalimin e dyshemeve dhe fushave sportive sipas standardeve të FIBA-s**, është e papërshtatshme dhe tejkalon kërkesat reale për projektin. Pika është e pajustificueshme, sepse:

1. Per tu konsideruar fusha sportive sipas standardeve te FIBA-s duhet te kete dimensionet sipas standardeve te saj *“The minimum dimensions for the entire court area are therefore 32.0m long and 19.0m wide” – “Dimensionet minimale për të gjithë zonën e fushes janë pra 32.0 m gjatësi dhe 19.0 m gjerësi.”* (<https://www.venueguide.fiba.basketball>)

Pra sipas projektit dhe paramases se ngarkuar nga ju Fusha ne Muzeqine ka 505m² ndersa Fusha ne Carraleve ka 422 m², gje qe nuk e ploteson kriterin per tu klasifikuar si fushe me standard te FIBA-se qe eshte minimum 608m². Prandaj si e merrni te drejten te kerkoni 2 punetore te qertifikuar me standarde te FIBA-se, gje qe nuk eshte relevante me terenin apo me fushat ku do te punohen

Kjo kërkesë është e pajustificueshme për nga natyra dhe përmasat e projektit. Sipas specifikimeve të vetë projektit, fushat sportive në Muzeqinë (505 m²) dhe Carralevë (422 m²) **nuk përmbushin kriteret minimale të FIBA-s** për t'u klasifikuar si fusha sipas standardeve të saj (dimensionet minimale janë 32m x 19m, ose 608 m²).

2. Certifikimi per instalimin e dyshemeve dhe fushave sportive sipas standardeve të FIBA-s nuk është kërkesë standarde për punëtorët në vendin tonë, pasi nuk ka një certifikim të tillë të njohur ligjërisht në Kosovë për punonjësit.
3. Ky kriter krijon **një barrierë të panevojshme** për konkurrencën, duke favorizuar nje operator që mund të kenë qasje në certifikata ndërkombëtare e qe dihet cila kompani mund te jete.
4. Kjo kërkesë mund te realizohet nga puntoret të cilët mund të kenë eksperiencë të mjaftueshme pa pasur certifikata ndërkombëtare, qe kane punuar pune te ngjajshme me dysheme sportive, lineliu apo edhe vinyl

Kjo kërkesë eshte kerkuar te hiqet edhe ne kerkesen per rishqyrtim te dates 07.08.2025 si e tillë nuk eshte hequr por është e vendosur me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE

i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Kjo kerkese duhet te hiqet.**

Kërkesa 6 Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit; 1. Autokorpe me lartësi mbi 15 metra me A teste,

Kërkesa për **autokorpë me lartësi mbi 15 metra dhe teste A**, është jashtëzakonisht specifike dhe e paarsyeshme për natyrën e këtij projekti, për arsye se:

1. **Projektet për rregullimin e sallave sportive** nuk kërkojnë përdorimin e një autokorpore me një lartësi të tillë, pasi puna që duhet realizuar është e natyrës së brendshme dhe nuk kërkon pajisje të tilla për ndihmën e lartësisë, ky pozicion mund të kryhet me skele levizese adekuate për salla.
2. **Autokorpo me lartësi 15+ metra janë kryesisht të nevojshme për punime në ndërtesa të larta** ose për projekte ndërtimi të hapësirave të mëdha, por nuk ka justifikim për kërkesën e një autokorpore të tillë në një projekt ku puna është tërësisht e fokusuar në rregullimin e sallave sportive të shkollave.
3. Në praktikë, këto punë mund të realizohen në mënyrë adekuate me **skeletë të lëvizshme** apo pajisje tjera standarde për punë në lartësi deri në 10 m, që është edhe lartësia maksimale e sallave përkatëse.
4. Kjo kërkesë është **e paarsyeshme dhe krijon një barrierë artificiale** për operatorët që mund të kenë mundësi të ofrojnë shërbime të tjera të nevojshme, por nuk janë të pajisur me pajisje specifike për këtë kërkesë të pazakontë.
5. Përdorimi i një kërkesë të tillë i vendos kërkesa të padrejta për ofertuesit dhe mund të **dëmtojë konkurrencën**, pa pasur një justifikim të qartë për nevojën e saj.
6. Gjithashtu mund të kërkohej Autokorp me lartësi me te vogël duke e ditur se lartësia maksimale e sallave është deri 10 m e pse të jete një kerkese fikse mbi 15m, kur e dijm qe jan ne numer te vogel ne Kosove apo te mos e themi troq eshte vetem nje cope ne gjithe Kosoven

Kjo kërkesë si e tillë është e vendosur me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Kjo kerkese duhet te hiqet.**

2. luge ngarkuese me fshise me fugi mbi 45KW

- Nuk është e qartë **arsyetimi teknik** për kërkesën për këtë pajisje në kuadër të punimeve për rregullim të sallave sportive të mbyllura.
- Një kërkesë e tillë krijon pengesë të panevojshme dhe **nuk ka lidhshmëri direkte me pozicionet konkrete të punimeve.**
- Në pozicionet e punimeve të përshkruara në dosjen e tenderit **nuk ka punë që kërkojnë bartje të materialeve me ngarkim të rëndë**, që do të justifikonin përdorimin e një luge ngarkuese. Transporti i materialeve (dysHEME, ngjitës, profile, etj.) mund të bëhet fare mirë me karroca dore apo mjete të vogla manovruese, të përdorshme brenda ambienteve shkollore.

- Luga me fuqi mbi 45 kW është një mjet i rëndë ndërtimi, zakonisht i përdorur në kantierë për zhvendosje dhe pastrim të dheut, zhavorrit ose mbetjeve ndërtimore – gjë që nuk ekziston në këtë projekt. **Kërkesa është teknologjike dhe jorelevante.**
- Kjo pajisje nuk është as vendimtare për cilësinë e zbatimit të punimeve, as nuk sjell përparësi teknike që justifikon përjashtimin e operatorëve të tjerë që nuk e posedojnë. Për rrjedhojë, kjo është një **kërkesë e panevojshme që kufizon konkurrencën në mënyrë artificiale**, pa ndikim real në realizimin e projektit.

Kërkesa 7.1. Certifikata EN651, që tregon specifikat teknike të cilësive për mbulesën e dyshemes së paku 5 puntor të thjeshtë.

Kjo kërkesë është **shumë e ngushtë dhe e paarsyeshme** për dy arsye kryesore:

EN 651: Ky standard është i lidhur me specifikat për **mbulesa të tjera të dyshemeve, saktësisht mbulesë dyshemeje prej polivinil kloruri me shtresë shkume** dhe nuk është në përputhje me materialet apo pozicionin e kerkuar nga ju sipas parametres për dysheme Sportive Pos 1.1.3 në dy sallat .

Në këtë rast, përdorimi i këtij standardi është i gabuar teknikisht dhe i pashoqëruar me arsyetim të qartë teknik, duke krijuar paqartësi dhe mundësi keqinterpretimi të qëllimshëm.

Si mund të kërkohej kjo certifikatë për një projekt që lidhet me **dysheme sportive**, kur ato janë të destinuara për **përdorime të tjera**? Ky është një **gabim i rëndë në kriteret e FTD** dhe nuk ka asnjë arsye që kërkesa për **EN 651** të qëndrojë.

Gjithashtu, në këtë pikë kërkohej edhe 5 punëtorë të thjeshtë, përderisa kërkesa të njëjta për 5 punëtorë janë bërë tashmë në pikën 9.1. Kjo krijon konfuzion dhe mbivendosje të kërkesave.

Kjo kërkesë si e tillë është e vendosur me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Kjo kërkesë duhet të hiqet.**

Në këtë mënyrë nga ana e AK-së janë shkelur një mori dispozitash ligjore të ndara, të lidhura dhe të varura me njëra tjetrën, që i kanë kushtuar rëndësi të veçantë parimeve dhe mënyrës së përcaktimit të kriterëve/kërkesave minimale për kualifikim për t'i mundësuar AK që të verifikojë se OE i posedon aftësitë e nevojshme kualifikuese nga neni 65-70 të këtij ligji, duke i kufizuar që të jenë: relevante/nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, që nuk mund të kenë peshë të caktuar, që nuk kufizojnë konkurrencën në mes OE, dhe që nuk janë diskriminuese kundër ose në favor të një ose më shumë OE.

Po ashtu është shkelur edhe neni 25.4 i Rregullores për prokurim publik i cili me rastin e përcaktimit të kriterëve obligon AK-në që t'i kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe të formuloni kërkesa minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk

përfshijon OE e themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe teknike.

Mirëpo, siç dëshmohet nga rrethanat faktike dhe ligjore, rezultojnë se nga ana e AK-së shkilen në mënyrë flagrante/arbifrare detyrimet ligjore, sepse kriteret e përzgjedhjes të vendosura në këtë aktivitet janë bazuar në konsideratë tjera e jo në parimet bazike dhe kërkesat ligjore të prokurimit publik nga nenet 1, 7, 51 të LPP-së; 17.17 dhe 25.4 të RRPP Nr.001/2023 dhe nenit 8 UPP 001/2023.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me këtë lloj te aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë** me nr. te prokurimit: **617-25-6934-5-2-1** te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Shtimes.

Urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të DRYSHOHEN DHE PËRMIRËSOHEN Kërkesat e lartcekura dhe të njejtat të paraqiten në përshtatje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit duke hequr kriteret diskriminuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, ne konsiderojmë qe AK na ka bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e e kërkesës për rishqyrtim dhe kësaj ankese për shkak se ka paraqitur kriteret diskriminuese dhe jo proporcionale me qëllimin e kontratës. Gjithashtu do të na pamundësohet konkurrimi në këtë procedurë të prokurimit edhe pse ne jemi të specializuar për kryerjen e punëve që kërkohen në specifiat teknike.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.